

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6831  
E mërkurë, 22 shkurt 2023  
çmimi 0.40 €

## Promovohet libri 'Kryemjeshtri' kushtuar trajnerit Driton Kuka

FAQE 10



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# PJETËR SHALA: KAM LUFTUAR KUNDËR MILLOSHEVIQIT, KURRË KUNDËR CIVILËVE.

FAQE 4-5



"Asnjëherë në jetën time nuk e kam bërë atë që më ngarkohet. Unë kam qenë vetëm një luftëtar. Në nuk kemi luftuar

kundër civilëve. Kam luftuar kundër një makinerie të regjimit të Millosheviqit, por kurrë kundër civilëve", ka theksuar

ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Pjetër Shala, në ditën e dytë të gjykimit ndaj tij

## DEPUTETËT NUK E VOTOJNË MARRËVESHJEN NDËRKOMBËTARE PËR KREDI ME FONDIN OPEC.

FAQE 3

## APEL PËR MOBILIZIM, NJË ÇEREK SHEKULLI NGA GJENOCIDI I FUNDIT NË KOSOVË.

FAQE 6

Qendra "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur"



## AKTUALE



**BIDENI NË POLONI: KIEVI QËNDRON I FORTË, NATO MË E BASHKUAR SE KURRË** F. 2

**QEVERIA THEMELON STRUKTURËN PËR HARTIMIN E STRATEGJISË KUNDËR KORRUPSIONIT** F. 7

**BERAT RUKIOI I BASHKOHET LDK-së** F. 6

**SPECIALJA BASTIS BANESËN E ISH-KËSHILLTARIT TË HASHIM THAÇIT** F. 6



## EKONOMI



**PAGESA E TATIMIT NË PRONË, NË PRITJE TË VENDIMIT FINAL** F. 8

## SPORT



**DRITA "ZHYT" NË KRIZË PRISHTINËN** F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Bideni në Poloni: Kievi qëndron i fortë, NATO më e bashkuar se kurrë

**VARSHAVË, 22 SHKURT** - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Joe Biden, tha në një fjalim në Poloni, se një vit pasi Rusia filloi agresionin ndaj Ukrainës, Kievi qëndron i fortë dhe NATO-ja është më e bashkuar se kurrë. “Një vit më parë bota ishte e shqetësuar për rënien e mundshme të Kievit. Unë mund të deklaroj: Kievi qëndron i fortë, Kievi qëndron krenar, qëndron i papërkulur dhe, më e rëndësishmja, qëndron i lirë”, ka thënë presidenti Biden në fjalimin që mbajti para Kështjellës Mbretërore të Varshavës. Në fjalimin që mbajti një ditë pas një vizite dramatike në Kiev, presidenti Joe Biden siguroi Ukrainën dhe aleatët e NATO-s për mbështetjen e palëkundur të Shteteve të Bashkuara. “Ukraina nuk do të jetë kurrë një fitore për Rusinë”, ka deklaruar ai. Presidenti Biden ka theksuar se “mbështetja për Ukrainën nuk do të ndalet, NATO-ja nuk do të

përçahet dhe ne nuk do të lodhemi”, ka pohuar ai. Bideni ka thënë se nuk duhet të ketë asnjë dyshim, se angazhimi i Shteteve të Bashkuara ndaj NATO-s dhe nenit 5 është i fortë, duke iu referuar parimit të NATO-s se një sulm ndaj një anëtar është një sulm ndaj të gjithëve. “Çdo anëtar i NATO-s e di këtë. Edhe Rusia e di: një sulm kundër njërit është një sulm kundër të gjithëve”. Presidenti amerikan tha se presidenti rus Vladimir Putin po përballet sot me demokraci më të forta. “Kur presidenti Putin urdhëroi tanket e tij të hynin në Ukrainë, ai mendoi se ne nuk do të bënim asgjë. Ai ishte i gabuar”, ka deklaruar Biden. Ai ka thënë se Rusia po kryen mizori ndaj Ukrainës, duke i quajtur veprimet e Moskës “krime kundër njerëzimit”. Bideni ka deklaruar se Shtetet e Bashkuara dhe partnerët e tyre do të shpallin më shumë sanksione



kundër Rusisë këtë javë lidhur me agresionin që filloi gati një vit më parë. Ai tha se Shtetet e Bashkuara

do të organizojnë një takim të nivelit të lartë të NATO-s vitin e ardhshëm në 75-vjetorin e

aleancës. Një ditë pas një vizite të paparalajmëruar në Ukrainë, prania e Bidenit në Varshavë përforcon mesazhin e përkushtimit amerikan ndaj krahut lindor të aleancës që ndodhet më pranë konfliktit dhe i dërgon një mesazh Moskës për unitetin perëndimor. Pas pritjes në Pallatin Presidential të Varshavës, presidenti Biden dhe ai i Polonisë Andrzej Duda mbajtën bisedime ku ritheksuan mbështetjen për Ukrainën dhe nevojën e ruajtjes së sigurisë në Evropë, në kushtet e agresionit rus. “Siç i thashë presidentit Zelenski kur folëm dje në Kiev, mund të them me krenari se mbështetja jonë për Ukrainën mbetet e palëkundur”, ka theksuar Bideni. Presidenti Biden e cilësoi marrëdhënien me Poloninë kritike për Shtetet e Bashkuara dhe shprehu vlerësimin për bashkëpunimin dhe ndihmën e saj.

## Reagime në Mal të Zi pas sulmit të policisë ndaj një shtetasi shqiptar

**PODGORICË, 22 SHKURT** - Policia në Mal të Zi njoftoi se videoja e publikuar në rrjetet sociale më 21 shkurt, në të cilën shfaqet keqtrajtimi i një shtetasi shqiptar nga pjesëtarë të policisë malazeze, është incizuar më 15 janar. Incidenti, sipas autoriteteve, ndodhi në pikën kufitare Sukobinë-Muriqan, afër Ulqinit. “Lidhur me këtë ngjarje janë ndërmarrë masa dhe veprime zyrtare që kanë rezultuar me zbulimin e identitetit të të gjithë aktorëve të përfshirë në ngjarjen e përmendur dhe po përcaktohet përgjegjësia e zyrtarëve të policisë”, u tha në njoftim. Më 16 janar Bashkimi Demokratik i Shqiptarëve, partia e Mehmed Zenkës, tha se një pjesëtar i Policisë së Malit të Zi kishte “keqtrajtuar një shtetas



shqiptar”. Së bashku me këtë njoftim, kjo parti prezantoi edhe një video të publikuar nga mediet shqiptare, duke kërkuar nga autoritetet që të zbulojnë se çfarë kishte ndodhur në pikëkalimin kufitar. “Bashkimi Demokratik i

Shqiptarëve u bënë thirrje organeve kompetente dhe kryeministrit [të Malit të Zi, Dritan] Abazoviq që të ndërmarrin masat e duhura për ta ndriçuar situatën e përdorimit të forcës nga policia ndaj

personave të paidentifikuar dhe për të sqaruar urgjentisht këtë situatë”, u tha në njoftim. Videoja është publikuar nga mediet shqiptare më 15 shkurt dhe nga “Podgoricki vremeplov” në Podgoricë pasditen e 21 shkurtit. Këto janë dy video të ndryshme të së njëjtës ngjarje, por videoja e dytë është më e gjatë dhe më e qartë, pasi është filmuar nga afër. Në videon e publikuar në një moment shihet dhe dëgjohet se si një burrë nga automjeti u thotë policëve se “nuk kam bërë asgjë”. Në video, po ashtu, dëgjohet fjalia “ule telefonin”, teksa polici nxjerr me dhunë nga makina shtetasin e huaj. Më 21 shkurt partia Alternativa Shqiptare tha se ky ishte “një incident i tmerrshëm, shkatërrues për Malin e Zi”, që

ndodhi pak ditë para mbledhjes së planifikuar të përbashkët të dy qeverive. Qeveria shqiptare dhe ajo malazeze do të mbajnë një mbledhje të përbashkët të hënën më 27 shkurt. Alternativa Shqiptare, partia e kryetarit të komunës së Tuzit, Nik Gjelošhaj, dënoi ashpër incidentin që ndodhi në pikën kufitare të Sukobinës në kufirin midis Malit të Zi dhe Shqipërisë. Sipas deklaratës së lëshuar nga partia Alternativa, cak i këtij incidenti ishte Petraq Milo, profesor universitar. Milo nga viti 2005 deri më 2013 ka qenë këshilltar i kryeministrit të Shqipërisë për financat publike dhe politikat monetare. Po më 2019 ai ishte emëruar këshilltar ekonomik i presidentit të Shqipërisë.

## Baerbock: Bota i ka kërkuar Putinit të mos bëjë kërcënime bërthamore

**BERLIN, 22 SHKURT** - Ministrja e Jashtme gjermane, Annalena Baerbock, ka thënë se komuniteti global i ka kërkuar vazhdimisht presidentit rus Vladimir Putin që të mos i përdorë kërcënimet bërthamore në përplasjen e tij me Perëndimin për luftën në Ukrainë. Duke folur pas një vizite në Turqi, Baerbock tha se vendimi i Putinit për ta pezulluar pjesëmarrjen në traktatin me Shtetet e Bashkuara që kufizon

arsenalin strategjik bërthamor të të dyja palëve, nënvizon rëndësinë e lëvizjeve drejt çarmatimit bërthamor. Në fjalimin e 21 shkurtit drejtuar kombit, Putini tha se është “i detyruar të njoftoj se Rusia është duke e pezulluar pjesëmarrjen në traktatin për armët strategjike”. Ai ka thënë se Rusia nuk po tërhiqet nga marrëveshja, mirëpo vetëm po e pezullon pjesëmarrjen. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, i ka

kërkuar Rusisë ta rishqyrtojë vendimin e saj për pezullimin e pjesëmarrjes në këtë traktat. I ashtuquajtur START-i i Ri është traktati i vetëm për armët bërthamore në mes të Shteteve të Bashkuara dhe Rusisë i cili është zgjatuar për pesë vjet më 2021. I nënshkruar fillimisht më 2010, ky traktat ua kufizon palëve posedimin e kokave bërthamore me rreze të gjatë në 1.550, shifër më e vogël sesa ajo që ka qenë në marrëveshjen fillestare.



# Pjetër Shala: Kam luftuar kundër Millosheviqit, kurrë kundër civilëve

“Asnjëherë në jetën time nuk e kam bërë atë që më ngarkohet. Unë kam qenë vetëm një luftëtar. Ne nuk kemi luftuar kundër civilëve. Kam luftuar kundër një makinerie të regjimit të Millosheviqit, por kurrë kundër civilëve”, ka theksuar ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Pjetër Shala, në ditën e dytë të gjyqimit ndaj tij

HAGË, 22 SHKURT (ER) - Ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Pjetër Shala, ndaj të cilit ka nisur gjykimi të martën si i akuzuar për krime lufte, ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë e vrasje të paligjshme, të kryera gjatë luftës, i ka mohuar të gjitha akuzat ndaj tij. “Asnjëherë në jetën time nuk e kam bërë atë që më ngarkohet. Unë kam qenë vetëm një luftëtar. Ne nuk kemi luftuar kundër civilëve. Kam luftuar kundër një makinerie të

regjimit të Millosheviqit, por kurrë kundër civilëve. Nëse është qëllimi i këtij institucioni të më dënojë pse kam luftuar për lirinë e popullit dhe vendit, është okej. Por, jo në këtë mënyrë, të njollosem dhe të baltosem. Këto nuk kanë qenë metoda tonat dhe të asnjë ushtari të UÇK-së”, ka thënë ai, për të vazhduar tutje: “Unë jetoj që 25 vjet në Belgjikë, në një shtet demokratik. Detyra e prokurorit është të kërkojë drejtësi, por jo t'i sajojë ato. Në Belgjikë kjo është e ndaluar.

Nuk e kam përkrahur këtë gjykatë asnjëherë, por deshi fati të jem para jush”, ka pohuar Shala.

Ai ka theksuar se “nëse ka pak drejtësi, pres të më shpallni të pafajshëm”.

Në ditën e dytë të gjyqimit pala mbrojtëse i ka mohuar akuzat e Speciales ndaj Shalës.

“Shala s’është monstër, as hero. Është njeri”, ka theksuar avokati i Shalës, Jean-Louis Gillissen në fjalën hyrëse. “Zotëri Shala nuk ka bërë asgjë më tepër sesa e ka ushtruar një prej të drejtave më të shenjta, e ka mbrojtur veten nga serbët. Ai nuk është kriminel. Portretizimi i prokurorisë për zotëri Shalën është fals. Prokuroria tha se ka pas frikësim të dëshmitarëve, por nuk tregon për çfarë rasti bëhet fjalë”, ka shtuar ai. Madje, sipas tij, kjo çështje penale është e mbështetur në thashetheme.

Dita e dytë e gjyqimit ndaj Shalës ka përfunduar të mërkurën, derisa më 27 mars do të paraqiten provat e të dëmtuarave. Në ditën e parë të gjyqimit, të martën, Shala ka thënë se akuzat ndaj tij janë të fabrikuara. “Nuk pranoj asgjë. Të gjitha janë të fabrikuara”, ka pohuar Shala para Dhomave të Specializuara me seli në Hagë. Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar, që ndryshe njihen edhe si Gjykata Speciale, hetojnë krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000. Këto krime të pretenduara përmenden në një raport të Këshillit të Evropës, të vitit 2011, autor i të cilit është senatori zviceran Dick Marty.

Gjykata është themeluar nga Kuvendi i Kosovës, por vepron në Hagë të Holandës.

Kjo gjykatë e ka shqiptuar dënimin e parë për krime lufte në dhjetor të vitit të kaluar.

Ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Salih Mustafa, është dënuar me 26 vjet burgim për vrasje të paligjshme, ndalim arbitrar dhe torturë. Më herët nga Dhomat e Specializuara në Hagë janë dënuar Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj për pengim të administrimit të drejtësisë.

Ndërkaq më 3 prill pritet të nisë gjykimi ndaj ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ish-krerëve të Kuvendit, Kadri Veseli e Jakup Krasniqi dhe ish-deputetit të Kosovës, Rexhep Selimi. Këta ish-krerë të UÇK-së akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.



## Osmani pranoi letrat kredenciale nga ambasadori i ri jorezident i Republikës Islamike të Pakistanit

PRISHTINË, 22 SHKURT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pranuar letrat kredenciale nga ambasadori i ri jorezident i Republikës Islamike të Pakistanit, Yousaf Junaid, të cilin e ka uruar për detyrën dhe ka shfaqur shpresën se gjatë mandatit të tij do të forcohen marrëdhëniet bilaterale. Me ambasadorin Junaid, presidentja Osmani bisedoi edhe për thellimin e

bashkëpunimit ekonomik dhe potencialin e rritjes së bashkëpunimit në sfera të tjera të interesit të dyanshëm. Presidentja Osmani falënderoi Pakistanin për mbështetjen e Kosovës, në veçanti në procesin e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare, me ç’rast ambasadori Junaid konfirmoi mbështetjen e shtetit të tij në këtë drejtim. Në raport me zhvillimet aktuale

politike dhe të sigurisë, presidentja Osmani ka theksuar se institucionet e Republikës vazhdojnë të jenë të përkushtuara për paqe të qëndrueshme dhe stabilitet. Osmani falënderoi ambasadorin Junaid për mbështetjen e rezervë që Pakistani i ka ofruar Kosovës përgjatë gjithë proceseve me rëndësi nëpër të cilat ka kaluar Kosova.





# Deputetët nuk e votojnë marrëveshjen ndërkombëtare për kredi me Fondin OPEC

PRISHTINE, 22 SHKURT - Kuvendi i Kosovës nuk e ka miratuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë për Programin e Financave Publike dhe Rritjes Ekonomike ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar. Në votim morën pjesë 85 deputetë, për ish-in 73 vota, kundër një dhe 10 deputetë abstenuan karshi kësaj marrëveshjeje ndërkombëtare. Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka kërkuar mbështetjen e deputetëve për këtë marrëveshje e cila kap vlerën 40 milionë dollarë. “Kap vlerën prej 40 milionë dollarësh amerikanë dhe është në formën e mbështetjes buxhetore të drejtpërdrejtë për buxhetin e shtetit. Kjo marrëveshje vjen si vazhdimësi e marrëveshjes për politika zhvillimore me Bankën Botërore. Ka qenë në pako me atë marrëveshje që është

ratifikuar në Kuvend. Programi me Fondin e OPEC ka për qëllim mbështetjen në formim, në transparencë fiskale dhe politikëbërje si dhe në përmirësimin e zhvillimit të mjedisit për zhvillimin e sektorit privat dhe inicimin e tranzicionit të gjelbër. Maturiteti është 20 vjet me grejs periudhë 5 vjet, pra nuk ka kthim të kredisë për 5 vjetët e para, por vetëm pagesë të interesit”, tha Murati. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Armend Muja, para votimit kërkoi prej pozitës dhe opozitës ta mbështetnin këtë marrëveshje. “Këto marrëveshje duhet të votohen me 2/3 të gjithë deputetëve. U kërkojmë të gjithë deputetëve, të pozitës e të opozitës, të miratojnë”, tha Muja. E deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti, ka propozuar që kjo marrëveshje të rinegociohet me Fondin OPEC. Ai tha se nuk ka ndodhur asnjëherë të merret

kredi për të bërë reforma në inspektive. “Për këtë marrëveshje nuk ka pasur asnjë diskutim paraprak, prandaj po jap vlerësimin e grupit tonë parlamentar. Kjo marrëveshje me Fondin OPEC për zhvillim ndërkombëtar, që është 40 milionë dollarë, është kredi për të miratuar ligje. Nuk është kredi për investime për ndonjë rrugë, impiant apo investim kapital qysh zakonisht kemi marrë nga institucionet ndërkombëtare. Për të mos e rrëzuar këtë, ne u dakorodam në grupin parlamentar që ta bëjmë një propozim: që ta tërhiqni propaz këtë marrëveshje dhe ta rinegocioni me Fondin OPEC dhe të sillni marrëveshje për ndonjë projekt kapital që vlerësoni se është i rëndësishëm, por me marrë kredi për zhvillim ndërkombëtar, për të bërë reforma në inspektive, kjo nuk ka ndodhur kurrë”, theksoi Hoti.

Edhe shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, u shpreh se kjo marrëveshje e kredisë duhet të lidhet me ndonjë projekt konkret. “Konsiderojmë se kjo marrëveshje është jashtëzakonisht e rëndësishme që të lidhet për ndonjë projekt kapital. Është mirë të na jepni një shpjegim dhe ta kemi pak më të qartë pozicionin e qeverisë karshi këtyre çështjeve që kemi ngritur si opozitë”, tha Tahiri. Edhe deputeti i AAK-së, Besnik Tahiri, kërkoi më shumë sqarime nga ministri Murati për këtë marrëveshje. “Ne si Aleancë për marrëveshje ndërkombëtare kemi pasur qëndrime të sakta e të qarta, por një elaborim më i thuktë na nevojitet për të hyrë në votim”, theksoi ai. Ndërsa Murati dha sqarime për opozitën. “Mbështetja buxhetore nënkupton se paratë shkojnë njësoj siç është

struktura tek investimet kapitale që janë në nivel 820 milionë euro, sepse janë për përdorim të lirë. Për më tepër, unë e kam sqaruar edhe në të kaluarën se kredi apo marrëveshje të tilla kemi nënshkruar me qëllim që ta evitojmë huamarrjen apo përmbushjen e nevojave të financimit të shtetit në tregun e letrave me vlerë në tregun vendor, për shkak se në të kaluarën çka ka ndodhur huamarrja apo nevoja e financimit është përmbushur duke marrë mjete nga sektori financiar në Republikën e Kosovës, kryesisht sektori bankar, gjë që ka ndikuar në shterje të likuiditetit. Ne po marrim para shtesë nga institucionet ndërkombëtare që shërbejnë si infuzion për ekonominë e vendit, pra rritet niveli i sasisë së parasë që është në qarkullim në treg përmes këtyre marrëveshjeve. Ky ka qenë qëllimi”, tha Murti. /KP/

# Specialja bastis banesën e ish-këshilltarit të Hashim Thaçit

Prishtinë, 22 shkurt - Dhomat e Specializuara të Gjykatës Speciale kanë bastisur të mërkurën banesën e Adil Behramajt, ish-këshilltarit të presidentit Hashim Thaçi. Lajmin për "Albanian Post" e ka konfirmuar avokati i Behramajat, Artan Çerkini. "Mund të konfirmoj në cilësinë e avokatit të Behramajt se bastisja është në rrjedhje e sipër. Pa përfunduar bastisja s'mund të them asgjë. Bastisja ka ndodhur rreth orës 08:30 të mëngjesit dhe është duke vazhduar", tha ai. Ish-këshilltari tjetër i ish-presidentit Hashim Thaçi, Artan

Behrami, përmes një shkrimi në rrjetin social "Facebook", e ka cilësuar këtë bastisje si "skandal të paprecedent". "Bastisja e banesës së mikut tonë dhe udhëheqësit të mediumit 'Demokracia', Adil Behramajt, nga Prokuroria e Gjykatës Speciale, është një skandal i paprecedent. Ky është një kërcënim i hapur ndaj gazetarëve dhe lirisë së medieve në Kosovë. Pa paragjykuar motivet, frikësimi i gazetarëve nuk i bën nder Prokurorisë Speciale të Dhomave të Specializuara", ka shkruar Artan Behrami.



## BE-ja tregon agjendën e takimit të 27 shkurtit në Bruksel



PRISHTINË, 22 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, do të takohen më 27 shkurt në Bruksel në kuadër të dialogut, ku do të diskutojnë për propozimin e Bashkimit Evropian për normalizimin e raporteve, i njohur si Plani Evropian. Siç bëhet me dije në faqen zyrtare të Zyrës për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borell dhe Miroslav Lajçak fillimisht do të zhvillojnë takime të ndara me Kurtin dhe Vuçiqin. Këto takime do të fillojnë në orën

15:00, ndërsa pasta do të ketë një takim të përbashkët. "Në takim do të diskutohet për propozimin e BE-së për normalizim të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë", thuhet në njoftimin zyrtar të Brukselit. Në fund të takimit bëhet me dije se do të ketë deklaratë për medie nga përfaqësuesi i lartë i BE-së, Josep Borrell. Pjesëmarrjen në takim e kanë konfirmuar edhe Kurti dhe Vuçiqi. Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë, Josep Borrell, ka thënë se shpreson që

Kosova dhe Serbia ta pranojnë propozimin evropian si rrugë për normalizim të marrëdhënieve. "Jam takuar me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq dhe kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti. Do të takohem me të dy në Bruksel më 27 shkurt, po i kam ftuar për të pasur një ditë të plotë me diskutime. Është një propozim në tryezë. Shpresoj që ata të jenë në gjendje ta pranojnë këtë propozim si rrugë për t'i normalizuar marrëdhëniet në mes tyre", është shprehur Borrelli për "Deutsche Welle"-n.

## Xhamitë në Kosovë mbledhin mbi 400 mijë euro për Turqinë

Prishtinë, 22 shkurt - Xhamitë në Kosovë kanë mbledhur 400 mijë e 500 euro mbështetje financiare për të prekurit nga tërmeti në Turqi, ka njoftuar kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim Tërnavë, gjatë një takimi që ka zhvilluar të mërkurën në Ambasadën e Republikës së Turqisë në Kosovë. Atje ai është pritur nga ambasadori Tunç Angli. "Myftiu Tërnavë fillimisht i dëshiroi ambasadorit punë të mbarë dhe të suksesshme në misionin e ri. Më pas, në emër të tij dhe në emër të të gjithë besimtarëve myslimanë, i shprehu ngushëllime për viktimat e tërmetit që goditi Turqinë disa ditë më parë", thuhet në komunikatën për medie të BIK-



ut. "Ai shprehu dhimbjen dhe solidaritetin e tij me të gjithë të prekurit nga ky tërmet, duke

lutur Zotin që të lënduarit t'i shërojë sa më parë, ndërsa të vdekurit Zoti t'i ketë marrë me

mëshirën e tij. Me këtë rast, Myftiu Tërnavë tha se besimtarët tanë, gjatë aksionit që kemi

organizuar në të gjitha xhamitë e Kosovës, kanë grumbulluar 400 500.00 euro si mbështetje materiale për të prekurit nga tërmeti, të cilat u transferuan sot në llogarinë bankare të Ambasadës". Ndërsa nga ana e tij, ambasadori Angli thuhet se ka falënderuar Myftiun Tërnavë për vizitën dhe për solidaritetin e treguar të besimtarëve myslimanë të Kosovës me të prekurit nga tërmeti. "Ai tha se populli turk është tejet mirënjohës dhe falënderues ndaj popullit vëlla kosovar për solidaritetin e treguar me popullin vëlla turk, si dhe për mbështetjen morale me të cilën kanë dëshmuar vëllazërinë dhe miqësinë e thellë ndërmjet dy popujve", përfundon njoftimi.

## Punëtorja për vetingun, vazhdon diskutimi dhe hartimi i Projektligjit

PRISHTINË, 22 SHKURT - Ministria e Drejtësisë është duke zhvilluar punëtorinë dyditore për hartimin e Projektligjit për Kontrollin e Integritetit të Pozitave të caktuara në Sistemin e Drejtësisë bazuar në kërkesën e Komisionit Ad hoc të Kuvendit për Vetëingun.

Projektligji i cili derivon nga Amendamentet Kushtetuese dhe hartohet në përputhje me rekomandimet e Komisionit të

Venecias ka për qëllim t'i përcaktojë rregullat, kriteret dhe procedurat për kontrollin e integritetit të subjekteve të kontrollit - nivelet e larta në sistemin e drejtësisë.

Sipas draftligjit, Autoriteti për Kontrollin e Integritetit do të jetë mekanizëm kompetent për realizimin e këtij procesi, i cili do të bëhet me qëllim të krijimit të një sistemi të drejtësisë të pavarur, të paanshëm dhe me

integritet.

Sipas kërkesës së Komisionit Ad hoc për këtë proces, drafti i finalizuar i Projektligjit do t'i dorëzohet Komisionit si autoritet kompetent për finalizimin e mëtejshëm dhe procedim më tutje.

Pjesë e kësaj punëtorie janë përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, shoqëria civile, partnerët strategjikë ndërkombëtarë dhe ekspertët e pavarur.



## Apel për mobilizim, një çerek shekulli nga gjenocidi i fundit në Kosovë

*Qendra "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur"*

Më 28 shkurt dhe 1 mars të vitit 1998 forcat e armatosura të Serbisë filluan zbatimin e projektit të gjenocidit ndaj shqiptarëve të Kosovës duke vrarë 24 civilë në fshatrat Likosha dhe Qirez të komunës së Skenderajt.

Nga data 28 shkurt 2023 e deri më 12 qershor 2024 janë qindra masakra që do të përkujtohen në 25-vjetorin e kryerjes së këtyre akteve gjenocidare. Prandaj e shohim tepër të rëndësishme që të gjitha institucionet shtetërore, politike, organizatat joqeveritare dhe shoqëritë artistike, kulturore dhe sportive, t'i mobilizojnë të gjitha energjitë që ta bëjmë të njohur në përmasa botërore gjenocidin që ka përjetuar populli shqiptar i Kosovës.

Mobilizimi ynë është një domosdoshmëri duke pasur parasysh se është njëra nga format më efikase të ndërkombëtarizimit dhe njohjes politike të këtij gjenocidi nga vendet e botës demokratike.

Popujt e tjerë që kanë qenë viktime të gjenocidit kanë ndjekur këtë rrugë! Kështu, në manifestimet për 50-të vjetorin e gjenocidit ndaj armenëve nga Perandoria Osmane që u organizuan në katër anët e globit ku ishin shpërndarë të mbijetuarit e këtij gjenocidi, ndodhi njohja e parë politike ndërkombëtare e tragjedisë që kishte përjetuar ky popull. Nëse përcillet me vëmendje kronologjia e njohjeve tjera politike ndërkombëtare të gjenocidit armen do të shohim



se manifestimet përkujtimore në vitet jubilarë kanë luajtur një rol të madh në sensibilizimin e qarqeve politike dhe intelektuale.

E njëjta gjë ndodhi edhe me gjenocidin e Perandorisë Gjermane ndaj grupeve etnike herero dhe nama. Më 14 gusht 2004, me rastin e 100 vjetorit të Betejës së Waterbergut, e cila simbolizon fillimin e gjenocidit që kanë kryer forcat shtetërore gjermane dhe kolonët gjermanë në Namibi, ministrja gjermane për Bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim, Heidemarie Wiczeorek-Zeul pranoi se "ajo që kishte

ndodhur në të kaluarën ishte një luftë shfarosëse që sot e quajmë gjenocid". Ndërsa, dhjetë vjet më vonë, në vitin 2015, në kontekst të përkujtimit të 100 vjetorit të gjenocidit armen, kur Gjermania mori përsipër edhe përgjegjësinë e vet si aleate e Perandorisë Osmane, ministri gjerman i Punëve të Jashtme Frank-Walter Steinmeier pranoi se lufta 1904-1908 mund të cilësohet "si krim luftë dhe si gjenocid".

Në këtë kontekst historik, në fund të vitit 2015 Gjermania dhe Nigeria filluan bisedimet për këtë çështje, të cilat u përmbyllën më 28 maj 2020.

Gjermania Federale njohu zyrtarisht se ka kryer këtë gjenocid dhe u angazhua për të paguar një miliard euro si ndihma për zhvillim të Namibisë.

Duke parë rezultatet që kanë arritur populli armen dhe ai i Namibisë, sidomos në vitet jubilarë të gjenocidit që u ka ndodhur atyre, del se organizimi ynë për sensibilizimin e opinionit botëror është më se i nevojshëm. Për këtë arsye duhet t'i shfrytëzojmë të gjitha resurset intelektuale e organizative, qeveritare e joqeveritare, që ta informojmë opinionin publik

ndërkombëtar, qarqet intelektuale dhe institucionet politike anekënd botës për tragjedinë kombëtare që kemi përjetuar gjatë luftës 1998-1999. Me një fjalë: Ta shndërrojmë vitin 2023 dhe 2024 në vit të informimit të plotë për gjenocidin që kemi përjetuar, me qëllim që drejtësia të triumfojë. Qendra "Gjenocidi në Kosovë-Plagë e hapur" shpreh gatishmërinë të ndihmojë me mundësitë e saj në organizimin e manifestimeve jubilarë në këtë çerekshkulli të krimit të gjenocidit ndaj shqiptarëve të Kosovës.

## Në veri konfiskohen 6 300 copë municion të kontrabanduar nga Serbia

PRISHTINË, 22 SHKURT - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka njoftuar se në veri të Kosovës janë konfiskuar 6 300 copë municion të kontrabanduar nga Serbia. "Përderisa Vuçiçi flet për armatosje të Serbisë, në veri të Kosovës konfiskohen 6 300 copë municion të kontrabanduar nga Serbia. 6 300 sasi të municionit

janë konfiskuar sot nga Njësi i Ndërhyrjes së Shpejtë të kufirit në Joshanicë në veri të Kosovës. Gjatë patrullimit është ndaluar vetura e dyshimtë me targa të Serbisë e një shtetas serb dhe njësitet relevante tashmë kanë ndërmarrë veprimet e nevojshme", ka shkruar Sveçla në "Facebook" Sipas tij, kjo rritet sërish faktin se grupe

të caktuara, të orkestruara dhe të mbështetura nga Beogradi, synojnë dhe angazhohen maksimalisht ta destabilizojnë vendin tonë. "Do të vazhdojmë pandalshëm angazhimin tonë në luftimin e çdo lloji kriminaliteti që synon ta cenojë sigurinë e vendit tonë dhe të qytetarëve tanë", ka shkruar ministri Sveçla.



## KDI-ja: Të rikthehet votimi elektronik në Kuvend dhe të bëhen publike votat individuale të deputetëve gjatë seancave

PRISHTINË, 22 SHKURT (ER) - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka theksuar se është bërë më shumë se një vit qëkur procesi i votimit në seancat e Kuvendit të Kosovës i është rikthyer praktikës së votimit me ngritje të dorës si rezultat i dështimit të procedurave tenderuese për ta rifunksionalizuar votimin elektronik.

KDI-ja vlerëson se mungesa e votimit elektronik po e cenon

funksimin transparent, por edhe llogaridhënien e Kuvendit. “Kështu, vullneti i përfaqësuesve të qytetarëve, i shprehur nëpërmjet votimit individual, mbetet i panjohur për qytetarët, megjë Kuvendi nuk po e publikon informatën se si secili deputet ka votuar lidhur me pikat e rendit të ditës ashtu siç parashihet me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Sipas Nenit 61, paragrafi 9 i Rregullores, ‘Publikimi i votimit me dorë

bëhet publike brenda dy (2) ditë pune pas përfundimit të votimit në seancë plenare”, ka njoftuar KDI.

Në mënyrë që të rritet transparencja dhe llogaridhënia e Kuvendit dhe e deputetëve individualisht, KDI-ja kërkon nga Kuvendi që në një afat sa më të shpejtë të mundshëm ta rikthejë votimin elektronik. “Në ndërkohë, Kuvendi, përveç publikimit të votave kumulative, duhet t’i bëjë të qasshme për



publikun rezultatet e votimit me individualisht në seancat e dorë për secilin deputet Kuvendit”, ka njoftuar KDI.

## Qeveria themelon strukturën për hartimin e Strategjisë Kundër Korrupsionit

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 SHKURT - Qeveria e Kosovës ka miratuar shqyrtimin e propozim-vendimit për themelimin e strukturës për hartimin e Strategjisë Kundër Korrupsionit. “Po e themelojmë strukturën për hartimin e Strategjisë Kundër Korrupsionit. Në këto gati dy vjet të qeverisjes kemi dëshmuar bindshëm dhe në vazhdimësi vullnetin për të luftuar krimin dhe korrupsionin si dhe për reforma në drejtësi e në administratën publike. Edhe përmes veprimeve tona të përditshme, edhe përmes vlerësimeve vjetore të raporteve ndërkombëtare sikurse ai i indeksit të Transparency International ose i Raportit të Bashkimit Evropian për vendin. Krahas vullnetit dhe guximit për t’i zbatuar ligjet në fuqi, kemi miratuar këtu edhe ligje të tjera, që do t’i jetësonin reformat e programit tonë qeverisës dhe ndryshimet për të cilat qytetarët tanë votuan masivisht dy vjet më parë. Ligji për Këshillin Prokurorial, që parashihet reformën në sistemin e drejtësisë; mandej Ligji për Zyrat e Publikë, që parashihet reformën në administratën publike; dhe Ligji për Byronë për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, që parashihet luftimin e korrupsionit



dhe padrejtësive, janë disa prej këtyre”, është shprehur Kurti. Ai ka shtuar se jo për rastësi këto ligje, bashkë me Ligjin për Masat e Përkohshme Mbrojtëse të Furnizimit me Produkte Themelore për Qytetarë, nëpërmjet të cilit bëhej parandalimi i abuzimit me rritjen e çmimeve të produkteve bazë,

janë dërguar në Gjykatën Kushtetuese nga opozita parlamentare. “Madje Ligji për Këshillin Prokurorial ka më shumë se gjashtë muaj që është në trajtim. Në historinë 15-vjeçare të shtetit të pavarur të Kosovës nuk mbahet mend që kaq shumë ligje të jenë kontestuar në Gjykatën

Kushtetuese brenda një kohë kaq të shkurtër. Kontestimi i tyre është përpjekje dëshpëruese për paralizim të reformave. Njëkohësisht është kundërshtim i hapur i nevojës shoqërore, i kërkesës qytetare dhe i vullnetit demokratik të 14 shkurtit 2021”, ka deklaruar Kurti, duke shtuar se, pavarësisht prej kësaj,

përkushtimi i qeverisë mbetet po i njëjti. “Zelli vetëm edhe më i madh. Ecja jonë nuk do të ndalet. Sot po e bëjmë hapin e radhës, me Strategjinë Kundër Korrupsionit, të cilën jam i bindur që me shumë kënaqësi do ta votojmë në këtë mbledhje gjithsecili prej nesh”, ka thënë kryeministri Kurti.

## Berat Rukiqi i bashkohet LDK-së

PRISHTINË, 22 SHKURT - Ligjëruesi universitar e doktoranti i ekonomisë Berat Rukiqi është bërë pjesë e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Lajmin e ka dhënë lideri i LDK-së, Lumir Abdixhiku. “Si ekonomist i dalluar e si aktivist i pandalshëm i angazhimit publik për një shoqëri të zhvilluar, Berati me gjithë bagazhin e tij intelektual e profesional do t’i japë vlerë projektit tonë politik. Berat Rukiqi ka magjistruar në

Bruksel mbi Politikën Ekonomike të Bashkimit Evropian, gjersa vazhdon studimet e doktoratës në Universitetin e Prishtinës. Si udhëheqës i Odës Ekonomike të Kosovës ai ka artikuluar në vazhdimësi pikëpamje të një ekonomie të lirë e të fuqishme. Ai i njeh mirë të gjitha sfidat e sektorit privat, sikurse njeh mirë domosdoshmërinë e kohës për një ambient që ankoron vendin tonë në stadi të reja zhvillimore”, ka thënë Abdixhiku.

Ai ka theksuar se LDK-ja është e lumtur që si adresë e vetme e njerëzve profesionistë po shton radhët e veta secilën ditë. “Gjatë vitit të fundit, sikurse Berati, LDK-së e strukturave tona u janë bashkuar aktivistë të shoqërisë civile, ligjërues akademikë, deputetë e kryetarë komunash. Të gjithë bashkë do t’i japim vendit një zgjedhje politike të pastër, profesionale e ndërtuese të së ardhmes”, është shprehur Abdixhiku.



# Pagesa e tatimit në pronë, në pritje të vendimit final



**PRISHTINË, 22 SHKURT** - Deri në fund të muajit prill qytetarët e Kosovës duhet ta bëjnë pagesën e kështit të parë të tatimit vjetor në pronë. Në të kundërtën, ata do të gjobiten. Afati për kështin e dytë të pagesës është fundi i muajit shtator. Nëse pagesa nuk bëhet me kohë, do të aplikohet një interes prej 0.65-përqindësh për secilin muaj që vonohet pagesa dhe një gjobë prej 10-përqindësh të tatimit të papaguar.

Tatimi në pronë është taksë vjetore komunale dhe përcaktohet nga shumëzimi i vlerës së pronës me normën tatimore. Kjo normë është 0.15 për qind e vlerës së përgjithshme të pronës. E faturat e tatimit në pronë këtë vit janë më të larta se më herët. Pas vlerësimit të përgjithshëm të tokave dhe objekteve rezidenciale, që ka bërë Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në fund të vitit të kaluar, tatimi në pronë për disa është rritur deri në 100 për qind e për disa ka mbetur i pandryshuar, pasi vlera e pronës, pas vlerësimit, nuk ka ndryshuar.

Disa qytetarë të anketuar nga "Radio Evropa e Lirë" në Prishtinë thonë se do ta paguajnë tatimin në pronë duke

pasur parasysh se mund të gjobiten, por presin të kenë lehtësira nga qeveria. "Tatimin në pronë e kam paguar rreth 80 euro vitin e kaluar. Tani që është shtrenjtuar më bëhet mbi 100 euro. Nuk e di saktë. Do të marr borxh dhe do ta paguaj, por po pres nga qeveria ta shqyrtojë vendimin. Shpresoj të na lirojë nga pagesa", thotë Hysni Mehmeti.

Hajriz Musolli tregon se fatura e tatimit në pronë këtë vit i është rritur për 50 euro. Ai thotë se nuk e ka paguar ende. "Çmimi është i lartë për standardin tonë, por do ta paguaj. Ta shohim nëse qeveria bën ndonjë lehtësirë", thotë Musolli. "Tatimi në pronë është rritur shumë. Po pres të lirohemi nga kjo pagesë. Nuk e di nëse do të kem mundësi ta paguaj", thotë Skender Bërbatovci, pensionist.

## Kërkohet pezullimi i tarifave të reja

Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Sazan Ibrahim, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se të gjithë kryetarët e komunave janë pajtuar që të pezullohet kjo rritje e tatimit në pronë. Sipas tij, alternativa më e mirë për

momentin është pezullimi, për të cilin duhet të vendosë niveli qendror. "Nëse rriten faturat për tatimin në pronë, kryetarët e komunave mendojnë se interesimi i qytetarëve për ta paguar këtë tatim do të bjerë. Edhe ashtu pagesat e tatimit në pronë nuk kanë qenë të mëdha", thotë Ibrahim.

Nga tatimi në pronë shteti i Kosovës ka të hyra vjetore deri në 40 milionë euro.

Të hyrat e mbledhura nga tatimi në pronën e paluajtshme arkëtohen në llogarinë e komunës ku ndodhet prona e paluajtshme dhe shfrytëzohen nga komuna për zhvillimin e infrastrukturës dhe projekte të tjera që përmirësojnë jetën e qytetarëve.

## Opozita, rezolutë për pezullimin e rritjes së tatimit në pronë

Kundër rritjes së tatimit në pronë janë edhe partitë opozitare. Lidhja Demokratike e Kosovës ka iniciuar një rezolutë në Kuvendin e Kosovës lidhur me këtë çështje. Në seancën e fundit parlamentare, më 16 shkurt, LDK-ja ka kërkuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve që ta pezullojë

rivlerësimin e pronave dhe faturat e tatimit në pronë për vitin 2023 të llogariten sipas vlerësimit paraprak. Përmes rezolutës, LDK-ja ka kërkuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve që ta sjellë në Kuvend edhe Ligjin për Tatimin në Pronë të Paluajtshme, duke kërkuar plotësim-ndryshim. Sipas LDK-së, ky ligj duhet të japë mundësi që ta përshtatë ngarkesën tatimore me situatën ekonomike, si dhe të ofrojë mundësi që të ndryshohet pragu tatimor.

Fleksibilitet të pragut tatimor me ligj ka kërkuar edhe Asociacioni i Komunave të Kosovës. Rezoluta e LDK-së pritet të nxirret sërish në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës, pasi që në seancën e fundit nuk kishte kuorum për ta nxjerrë në votim.

## Shatri: Rritja e faturave të tatimit në pronë mund të anulohet

Eksperti i çështjeve ekonomike, Haki Shatri, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se përderisa komunat janë pajtuar që të ketë pezullim të vendimit për rritje të tatimit në pronë, qeveria mund

ta bëjë një gjë të tillë. Shatri, i cili më herët ka qenë ministër i Financave, thotë se me këtë veprim nuk do të shkelej asnjë rregullore dhe asnjë një ligj. "Mënyra më e mirë për ta eliminuar këtë problem në këtë kohë të krizës ekonomike për qytetarët është që Ministria e Financave t'i propozojë qeverisë që të anulohet vendimi për tatimin në pronë për vitin 2023 dhe ta kthejë në nivelin e vitit 2022. Kjo është më e thjeshta derisa të fillohet me plotësim-ndryshim të ligjit", thotë Shatri.

Por, për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve e vetmja zgjidhje është plotësim-ndryshimi i ligjit. "Alternativa jonë është që për vitin aktual të lehtësohet barra për qytetarët, ndërsa për vitet e tjera pasuese të kemi ndryshim-plotësim të ligjit", ka thënë ministri i Financave, Hekuran Murati, në seancën e Kuvendit të Kosovës më 16 shkurt. "Propozimi ynë fillestar është që prona deri në 50 mijë euro të jetë e liruar tërësisht nga tatimi, ndërsa pjesa tjetër të bëhet në formë progresive - sidomos ata që kanë miliona euro prona", ka thënë Murati, duke paralajmëruar se projektligji do të dalë së shpejti në Kuvend.

Për këtë vit Murati ka propozuar që secilit tatimpagues t'i falen deri në 100 euro të faturës së tatimit në pronë. Sipas tij, 85 për qind e tatimpaguesve nuk do të paguanin asgjë për vitin 2023, 10 për qind të tjerë do të paguanin më pak se 100 euro dhe vetëm 5 për qind e tatimpaguesve do të paguanin më shumë se 100 euro. Në ligjin e ri Murati ka thënë se do ta përfshijnë edhe dispozitën e faljes së faturës së tatimit deri në 100 euro për vitin 2023.

Me ligjin në Kosovë, vlerësimi i pronës nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve bëhet në çdo tre ose pesë vjet. Vlerësimin e fundit kjo ministri e ka bërë vitin e kaluar, kurse zbatimi i tij në tatimin në pronë ka filluar nga janari i këtij viti.

Vlerësimi paraprak është bërë në vitin 2019.

Çështja e tatimit në pronë është bërë temë diskutimi pas reagimit të qytetarëve në rrjetet sociale, të cilët kanë treguar se faturat e tyre të tatimit në pronë janë rritur.

## Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë e Kosovës ishte pjesë e "Unstoppable Conference"

**PRISHTINË, 22 SHKURT** - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë e Kosovës (DhTIK), me qëllim të ngritjes së vetëdijes mbi nevojën për qasje dhe mundësi të barabarta të grave dhe burrave në vendimmarrje në të gjithë sektorët, veçanërisht atë të biznesit, ishte pjesë e "Unstoppable Conference".


"Unstoppable Conference" kishte rreth 60 panelistë dhe mbi 150 pjesëmarrës nga mbi 20 shtete të ndryshme. Konferenca "Unstoppable" është organizuar nga Western Balkans Fund dhe mbështetur nga Ministria e Punëve të Jashtme të Japonisë dhe Visegrad Fund. "Si DhTIK është gjithmonë kënaqësi t'i

gërshetojmë përvojat me personalitete nga rajoni dhe bota për të diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit dhe avancimit të biznesit kosovar në tregje rajonale dhe ndërkombëtare! Në këtë konferencë Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë është prezantuar nga drejtoresha Zana Beqiri", ka njoftuar DhTIK.





# Për sa para kemi vërtet nevojë?



## Nga Andreas MATTHIAS

Leon Tostoi ka shkruar një tregim të mrekullueshëm me titull "Sa tokë i nevojitet një njeriu?". Ai rrëfen historinë e një njeriu që iu dha mundësia të merrte aq shumë tok sa do të mund të përshkonte në këmbë duke ecur gjatë gjithë ditës. Burri nisi të ecte, dhe në çdo moment mendonte se po lodhej dhe mund të kthehej pas, lakmia e nxiste të ecte edhe pak më tej.

Tek e fundit pse duhet ta linte pa marrë edhe atë copë tokë që nuk i përkiste askujt. Kështu ai ecën i lumtur deri në orët e vona të pasdites. Por në një moment e kupton se dielli është gati të perëndoje dhe se duhet të nxitojë për t'u kthyer në pikën e nisjes për të mbyllur rrethin, përndryshe do ta humbasë gjithë tokën që kishte rrethuar deri në atë momente. Kështu ai nisi të kthehet me vrap. Ai vrapon dhe vrapon dhe arrin pikën e nisjes pikërisht në momentin e fundit kur dielli sapo po fshihej në horizont. Por në çastet e fundit bie përtokë dhe nuk ngrihet më. Kishte vdekur nga lodhja ekstreme. Ai u varros po aty, dhe ky rrëfim dhe në këtë pikë kuptohet se se sa tokë i nevojitet një njeriu. Aq sa për t'u prehur pas largimit nga kjo botë.

## Çfarë është prona sipas From

Kjo lloj prone mund të quhet pronë private (nga latinishtja private, të privosh nga), sepse personi ose personat që e zotërojnë janë zotëruesit e saj të vetëm, me fuqi të plotë për t'i privuar të tjerëve nga përdorimi apo gëzimi i saj. Ndërsa pronësia private supozohet të jetë një kategori natyrore dhe universale, ajo është në fakt një përjashtim

dhe jo rregull nëse marrim parasysh të gjithë historinë njerëzore (përfshirë parahistorinë), dhe veçanërisht kulturat jashtë Evropës, në të cilat ekonomia nuk ishte shqetësimi kryesor në jetë.

Përveç pronës private, ekzistojnë: prona e vetë-krijuar, e cila është ekskluzivisht rezultat i punës së dikujt; prona e kufizuar, e cila kufizohet nga detyrimi për të ndihmuar të tjerët; prona funksionale apo personale, e cila përbëhet ose nga mjete pune ose nga sende për kënaqësi; pronë e përbashkët, të cilën një grup e ndan në frymën e një lidhjeje të përbashkët, siç është kibuci izraelit. (Erik From, Të kesh apo të jesh)

## Prona private dhe mënyra e të pasurit

Mosbesimi ndaj pronës private dhe efekteve të saj mbi psikikën njerëzore nuk është një ide ekskluzive e From. Që nga kohët e lashta, filozofët kanë e theksuar se prona private është rrënja e shumë pakënaqësive në jetën e njeriut. Jezu Krishti thoshte: "Sërish po ju them: E ka më të lehtë një deve të kalojë në vrimën e gjilpërës, sesa një njeri i pasur të hyjë në mbretërinë e Perëndisë" (Mateu 19:24).

Ndërkohë filozofi i Greqisë së Lashtë Epikuri shkroi: Ai që i kupton kufijtë e jetës, e di se sa e lehtë është të gesh mjaftueshëm sa për të hequr dhimbjen e mungesës, dhe për ta bërë të gjithë jetën të plotë dhe të përsosur. Prandaj ai nuk ka më nevojë për gjëra që nuk duhen fituar veçse me punë dhe konflikt. Natyrisht, gjërat "të cilat nuk fitohen veçse me punë dhe konflikt" janë të mira materiale, të cilat njeriu mund t'i ndjekë gjatë gjithë jetës, pa marrë kurrë aq

mjaftueshëm sa për të kënaqur epshin. Por duke qenë psikolog Erik From, shkon një hap më tej: Egoja jonë është objekti më i rëndësishëm i ndjenjës sonë pronësore, sepse ajo përfshin shumë gjëra: trupin tonë, emrin, statusin tonë shoqëror, pasuritë tona (përfshirë njohuritë tona), imazhin që kemi për veten dhe imazhin që duam të kenë të tjerët për ne.

Egoja jonë është një përzjerje e cilësive reale, si njohuritë dhe aftësitë, dhe i disa cilësive fiktive që ne i ndërtojmë rreth një thelbi të realitetit. Problemi sipas From nuk është vetëm që ne kalojmë pjesën më të madhe të jetës sonë duke ndjekur të mirat materiale, por që e përkufizojmë veten përmes të mirave që zotërojmë.

## A janë disa dëshira më të mira se të tjerat?

Epikuri besonte se mënyra më e besueshme për të qenë të lumtur është të pakësosh dëshirat, derisa të jetë e lehtë që t'i kënaqësh ato. Por kjo qasje ka jo pak probleme. Për shembull, humbja e pasurisë sonë materiale në ndonjë aksident, ndoshta në një zjarr apo një grabitje, do të kërcënonte thelbin e qenies sonë dhe do të asgjësonte veten tonë.

Meqenëse ne jemi të vetëdijshëm për këtë mundësi gjithmonë të pranishme, jetët e njerëzve që jetojnë në këtë "mënyrë të pasuri" do të jenë gjithnjë në ankth, nën hijen e frikës ekzistenciale jo vetëm humbjes së një grumbulli gjërash, por të vetë identitetit të tyre. Pra i asaj që i përcakton ata si qenie njerëzore por që i jep vlerë jetës së tyre.

## Të jetosh siç je

Por ka pasur gjithmonë njerëz që e kanë jetuar jetën e tyre si

shembuj tipik se si mund të jesh i lumtur pa pasur, pa i privuar të tjerët nga përdorimi i pronës së tyre "private". Filozofi i lashtë grek Diogjeni jetonte në një qyp të madh prej qeramike në tregun e madh të Athinës, duke refuzuar që të transferohej në një shtëpi normale.

Një ditë, teksa po merrte rreze dielli para qypit të tij, Aleksandri i Madh (student i Aristotelit) shkoi që të takonte njeriun e famshëm. Aleksandri, i zilepsur nga jeta e shkujdesur e Diogjenit, e pyeti atë se çfarë mund të bënte për të. Në atë moment Aleksandri ishte një nga njerëzit më të pushtetshëm, ndoshta ekuivalenti i presidentit të SHBA-së sot.

Pa e ngritur kokën për ta parë, Diogjeni iu përgjigj me zë të ulët mbretit të famshëm: "Lëviz pak anash, se po bllokun rrezet e diellit". Ka edhe shumë shembuj modernë të njerëzve që në një moment e kanë kuptuar se jeta e tyre brenda shoqërisë sonë kapitaliste nuk çon askund dhe që u larguan për të gjetur lumturinë në ndjekje të tjera, larg luftës së pafundme për të mirat materiale.

Njëri prej tyre është Brendon Grimshou, ish-gazetar dhe sipërmarrës, që braktisi jetën dhe punën e tij komode dhe u transferua në ishullin e vogël Mojen në Sejshell për të kaluar pjesën tjetër të jetës duke mbjellë pemë dhe duke rikrijuar xhunglën origjinale në atë ishull. Thelbi i argumentit të From kundër mënyrës kapitaliste të jetesës, nuk është se ne të gjithë duhet të dalim të jetojmë rrugëve duke pasur me vete vetëm një çante shpine. Përkundrazi, duhet ta shikojmë jetën tonë të përditshme në një mënyrë më kritike, duke u përpjekur të shohim se ku nevojat jonë për të zotëruar gjëra bëhet

shkatërruese për mirëqenien dhe shëndetin tonë mendor.

"Idetë dhe besimet mund të bëhen një pronë, ashtu si edhe zakonet. Për shembull, kushdo që ha të njëjtin mëngjes, në të njëjtën kohë çdo mëngjes, mund të shqetësohet edhe nga një ndryshim i lehtë në atë rutinë, sepse zakoni i tij është kthyer në një pronë, humbja e së cilës rrezikon sigurinë e tij". (Të kesh ose të jesh).

Prandaj duhet të shfrytëzojmë rastin që duke nisur nga fundjava e ardhshme të distancohemi sadopak nga orientimi ynë material në jetën tonë. Le të përpiqemi të zbulojmë gëzimin e jetës, siç na kanë treguar njerëz të çuditshëm dhe ndoshta të mençur, nga Diogjeni dhe Epikuri dhe From: le të përpiqemi të jetojmë një fundjavë pa shpenzuar para.

## Si të jetosh një jetë aristoteliane

Teoria e Aristotelit mbi lumturinë mbështetet në tre koncepte: virtytet; phronesis ose urtësia praktike; dhe eudaimonia ose lulëzimi. Nëse keni nevojë të kujdeseni për një familje, bëni pazaret që të premtën në mbrëmje, në mënyrë që të mos keni nevojë të prekni paratë të shtunën dhe të dielën.

Nuk po ju thotë njeri të vdisni nga uria, dhe nëse keni nevojë të hani diçka të fituar nga puna vazhdoni. Por është një sport interesant, të mendosh se si mundet të mbijetosh në botën tonë të sotme për një fundjavë pa konsumuar gjë. A mund ta zëvendësoni një vizitë në një kafene ose në një vend tjetër argëtimi me një shëtitje në natyrë?

"Daily Philosophy" – Bota.al

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Promovohet libri 'Kryemjeshtri' kushtuar trajnerit Driton Kuka

PRISHTINË, 22 SHKURT - "Kryemjeshtri" është titulli i librit i promovuar të mërkurën në Bibliotekën Universitare të Kosovës kushtuar trajnerit më të mirë në botë në sportin e xhudos, Driton Kuka, me autor Arsim Maxheran.


Roli i trajnerit Kuka në promovimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare u vlerësua lart nga figura të shquara nga fusha e sportit dhe politikës në vend duke e cilësuar atë si udhëheqës në sukseseve të njëpasnjëshme që Kosova i ka arritur me anë të sportit të xhudos.

Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, ka thënë se ky libër do të dëshmojë dhe do ta shpërfaqë rrugën e gjatë të përshkuar nga trajneri Driton Kuka deri te sukseset kulminante. Ai tutje theksoi se sporti i xhudos do ta ketë përkrahjen e vazhdueshme të kësaj ministrie dhe të shtetit në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e sukseseve në këtë sport, formulën e të cilave Kuka duhet ta mbajë sekrete përballë shteteve të tjera. "Përgëzime për autorin e librit, vepër e madhe, vepër kapitale. Në të gjitha



takimet me homologë të shteteve të tjera, pyetja e zakonshme që kam pasur është si keni arritur këtë sukses në xhudo? Përgjigjja ka qenë nuk e di. E di vetëm Dritoni. Ai e ka formulën, e shpresoj të mos jetë në libër, e pastaj ta përvetësojnë të tjerët", ka thënë ministri Çeku. Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi, duke e falënderuar autorin për librin e botuar, ka thënë se medaljet e shumta, në mesin e të cilave tri të arta olimpikë, dëshmojnë dhe vërtetojnë se puna e Tonit është e pakrahueshme dhe e papërsëritshme në këtë sport. Autori i librit, Maxhera, theksoi se megjithëse ka shumë më

Haradinaj. Haradinaj tha se Kosova shpeshherë ka renditur sukseset në arenën ndërkombëtare falë xhudistëve dhe kryetrajnerit Driton Kuka. "Xhudoja mbetet sporti kulminant në vendin tonë. Kosova jo rrallë dukej më e mira përballë shumë shteteve të



mëdha botërore e evropiane falë xhudistëve tanë të cilët radhitnin triumfet një nga një. Padyshim, ky sukses është meritë e mjeshtrit të madh Toni Kuka dhe familjes së tij, të cilët me suksesin e tyre bënë krenar një popull duke sjellë Kosovës qindra medalje të

arta. Toni Kuka me punën e tij ka arritur të nxjerrë kampionë në nivel botëror si; Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova, Akil Gjakova, Distria Krasniqi e shumë të tjerë, duke u bërë inspirim për shumë të rinj. Ishte kënaqësi e veçantë të marr pjesë në promovimin e librit 'Kryemjeshtri', të autorit Arsim Maxhera, kushtuar jetës dhe suksesit të tij. Sukseset e tij janë frymëzuese për promovimin e imazhit të Kosovës kudo në botë", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Ndërsa kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, i cili ka qenë ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka thënë se të arriturat e Tonit si trajner janë të jashtëzakonshme dhe shkojnë përtej dimensionit sportiv. Ai është shprehur krenar se në kohën kur ka qenë ministër ka pasur rastin të punojë me Kukën dhe Federatën e Xhudos së Kosovës. "Të arriturat e Tonit si trajner janë të jashtëzakonshme dhe shkojnë përtej dimensionit sportiv, duke e shndërruar atë dhe xhudistët e udhëhequr nga ai në ambasadorët më të mirë të vendit tonë, të cilët e kanë bërë të njohur Kosovën në mbarë botën. Ishte nder dhe krenari për mua, që si ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të bashkëpunoja ngushtë me Tonin dhe Federatën e Xhudos së Kosovës, në periudhën më sfiduese për ta, por edhe kohën e artë të sukseseve të tyre të panumërta. Përmbledhja e këtyre sukseseve në një libër është falënderim dhe mirënjohje meritore për vizionin, përkushtimin dhe këmbëngulësinë e Driton Kukës në lartësimin e sportit të xhudos dhe të Republikës së Kosovës!", ka thënë Krasniqi.



## Drita "zhyt" në krizë Prishtinën

### "Epoka e re"

LIPJAN, 22 SHKURT - Drita e Gjilanit e ka fituar ndeshjen derbi me Prishtinën e cila është zhvilluar në stadiumin 'Sami Kelmendi' në Lipjan dhe ka përfunduar me rezultat 1-2. Drita në këtë mënyrë e ka "zhytur" edhe më shumë Prishtinën në krizë të rezultateve, pasi është humbja e tretë radhazi. Kryeqytetasit kaluan të parët në epërsi me golin e Jalen Aleix Blesan, por gjilanasit barazuan në fund të pjesës së parë, kur Krasniqi

realizoi nga penalltia për rezultatin 1-1. Në pjesën e dytë Blend Baftiu shënoi për rezultatin final 1-2. Drita me këtë fitore barazon pikët me Ballkanin që është në vendin e parë, por ka një ndeshje më pak, ndërsa Prishtina është në pozitën e katërt me 27 pikë. Në ndeshjen tjetër Gjilani e mposhti Drenicën me rezultat 2-1. Golat e fitores për gjilanasit i realizuan Kelmendi dhe Zabërgja, ndërsa për kuqezinjtë shënues ishte Dervishaj. Ndeshja e tretë që u zhvillua sot në mes të Malishevës dhe Ferizajt



përfundoi pa fitues 1-1. Për vendësit shënoi Mustafa, kurse për ferizajasit realizues ishte Halili. Sot (e enjte) zhvillohen dy ndeshjet e tjera të javës së 21-të në Superligë, ndërsa takohen Trepça '89 - Ballkani dhe Dukagjini - Llapi.

### SUPERLIGA - Xhiroja 21

Të enjten takohen:  
13:00 Trepça '89 - Ballkani  
13:00 Dukagjini - Llapi

Prishtina - Drita	1-2
Malisheva - Llapi	1-1
Drenica - Gjilani	1-2

## Rrahmani: Duhet të mbesim të koncentruar kundër Frankfurtit

NAPOLI, 22 SHKURT - Amir Rrahmani po e shijon në maksimum momentin magjik të Napolit. Skuadra italiane e regjistroi mbrëmë një fitore të rëndësishme në Ligën e Kampioneve duke e mposhtur Eintracht Frankfurtin në udhëtim me rezultat 2-0.

Rrahmani pret që edhe në ndeshjen kthyesë kundër Frankfurtit, Napoli të ketë paraqitje stabile. "Ka një përmirësim të krejt skuadrës. Jemi duke shkuar mirë. E dimë që jemi të fortë. Mendojmë dhe mundohemi të japim gjithçka në çdo ndeshje. Nuk

kemi pësuar gol që pesë ndeshje dhe është një gëzim dhe një ndjenjë e mirë. Mund të ndodhë gjithçka, por mendoj se edhe në ndeshjen e kthimit Eintracht do ta bëjë një lloj të njëjtë të lojës. Duhet të mbesim të koncentruar", ka deklaruar Rrahmani në "Mixed

Zone".

Napoli është lider dhe favoriti i padiskutueshëm për t'u shpallur kampion i Italisë. Gjithashtu, Rrahmani me shokë e bënë një fazë të grupeve pothuajse të përkryer në Ligën e Kampioneve, ndërsa tash janë në rrugë



mjaft të mirë të shkojnë në çerekfinale të kësaj gare.

## Benzema: Duam ta fitojmë prapë Ligën e Kampioneve

MADRID, 22 SHKURT - Sulmuesi i Real Madridit, Karim Benzema, është i lumtur me fitoren e arritur kundër Liverpoolit në Ligën e Kampioneve (2-5). Autori i dy golave në këtë ndeshje dhe fituesi i "Topit të Artë" në edicionin e kaluar ka thënë se synim i Realit është që sërish ta rrëmbejë titullin në Ligën e Kampioneve. "Ishte një natë e rëndësishme. Dua t'ia dedikoj këtë paraqitje presidentit tonë të nderit, Amancio. Kjo fitore është për të nga ana jonë. Luajtëm me personalitet dhe me produktivitet të golit. Duam ta fitojmë prapë Ligën e Kampioneve. I dhamë jetë një loje fantastike edhe për ata që na shikuan. Fillimi ishte i keq, tifozët në 'Anfield' na vunë nën presion, por më pas është parë Real Madridi i vërtetë", ka thënë Benzema. "Ishim gati përballa një ndeshjeje të madhe, ishim duke humbur 0:2 dhe dëshironim më shumë. Një gol mund të ndryshojë gjithçka dhe



kjo ndodhi falë Viniciusit. Dua t'i falënderoj tifozët tanë që sonte ishin lojtari ynë i 12-të.

Tash na pret një ndeshje e madhe në 'Bernabeu', ka shtuar Benzema.

## Westbrooku rikthehet në Los Anxhelos, përforcohen Miami dhe Chicago

LOS ANXHELOS, 22 SHKURT - Merkato e NBA-së nuk ndalet dhe ditët e pushimit për shkak të All Star Game po dhurojnë të tjera surpriza si ato të fillimshkurtit. Kështu, Russell Westbrook, që u transferua nga lakersat tek Utah Jazz si pjesë e një marrëveshjeje që preku tri skuadra, pritet të ndryshojë ekip. Westbrook pritet të rikthehet në Los Anxhelos, por për të luajtur me clippersat pjesën e mbetur të sezonit. Lojtari zgjidhi në mënyrë konsensuale kontratën me Jazz, ku nuk luajti asnjë minutë, pasi kërkon një skuadër tjetër dhe clippersat janë gati ta mirëpresin. Një tjetër lëvizje që do të finalizohet këtë javë është ajo e transferimit të basketbollistit Kevin Love nga Clevelandit te



Miami. Lojtari mbylli para kohe marrëveshjen me Clevelandin, që skadonte në fund të sezonit, për t'u transferuar te Miami, që ishte në kërkim të një qendre me përvojë në NBA. Edhe ekipi i Chicago Bulls ka bërë një lëvizje në orët e fundit, duke sjell Patrick

Beverley, që në pjesën e parë të sezonit ka luajtur me lakersat. Lojtari u largua tek Orlando për disa ditë si pjesë e një shkëmbimi, por më pas doli si "free agent". Ai do të firmosë me Bulls një kontratë deri në fund të sezonit.

## Klopp: Pësuam goditje të madhe, por kualifikohemi në Madrid

Liverpooli mori goditjen e radhës, pasi në "Anfield" u mposht thellë nga Real Madridi (2-5) në Ligën e Kampioneve. Pavarësisht prej kësaj humbje, Jurgen Klopp beson te kualifikimi, me

trajnerin gjerman që pranon mbrëmjen e dobët, por nuk dëshiron të dorëzohet. "E nisëm në mënyrë të shkëlqyer, kishim gjithçka që donim, u ndjemë mirë, shënuam dy gola dhe atmosfera ishte e

jashtëzakonshme. Më pas ata shënuan çdo gjë u shkatërrua. Goli i dytë i tyre ishte një shuplakë, duhet ta pranojmë, por pas pjesës së parë kam pasur ende ndjenja shumë pozitive. Kjo ishte një goditje e

vërtetë. Ne humbëm shumë topa në momentet e gabuara, nuk mbaj mend një pasim për Nunez në pjesën e dytë", ka thënë Klopp. "Në fund ua thashë djemve se ishte një goditje e madhe, por një

humbje është më e thellë nëse ne nuk mësojmë prej saj. Ne do të mësojmë dhe do të përpiqemi përsëri. Ne ende duam të fitojmë në Madrid dhe të kualifikohemi", ka shtuar Klopp.

### SHKURT

#### Trepça '89 transferon sulmuesin ganez Ebenezer Adu-Kwaw

KF Trepça '89 ka njoftuar se e ka transferuar sulmuesin ganez Ebenezer Adu-Kwaw. Sulmuesi vjen në klubin mitrovicas si zëvendësues i Christian Mba, i cili tashmë është transferuar në kampionatin shqiptar. 21-vjeçari vjen nga Superliga e Ganës, ndërsa e ka bindur stafin për t'i u bashkuar skuadrës dhe të jetë pjesë e "Minatorëve". "Adu u paraqit në ndeshjen ndaj Llapit ku pati disa minuta në fundin e ndeshjes dhe barti numrin 99, të cilin e barti paraardhësi i tij Mba. Siç dihet tash e disa kohë, klubi mitrovicas nuk ia huq në transferimin e sulmuesve", thuhet në njoftimin e 89-shit.

#### Manaj, afër kalimit te Cosenza

Sulmuesi Rey Manaj është larguar me marrëveshje nga Watfordi. Futbollisti shqiptar sapo është kthyer nga lëndimi dhe nëse një klub interesohet, duhet ta presë edhe rikuperimin e tij. Në mediet italiane, sipas medieve lokale "ildot.it", Manaj është në 'radarin' e Cosenzas, ekip që ndodhet në Serinë B dhe po lufton për mbijetesë. Manaj shihet si lojtar i duhur për të ndihmuar në arritjen e objektivit. Gjithashtu nga Spanja është raportuar se nuk përjashtohet edhe një rikthim tek Albaccete në Kategorinë e Dytë spanjolle.

#### Usyk, Furyt: Po mban titujt peng, tërhiq nëse ke frikë

Boksieri ukrainas Oleksandr Usyk ka përdorur sërish rrjetet sociale për t'i kujtuar kolegut të tij britanik Tyson Fury se koha po kalon për të organizuar një duel që do t'i unifikojë titujt kampionë bote në peshën e rëndë. "Jam këtu, po pres për ty!", ka qenë komenti i Usyk. Prej kohësh përflitet se dy boksierët do të duelojnë më 29 prill, por ende nuk ka asgjë konkrete si për sa i përket datës ashtu edhe vendit. Si Usyk ashtu edhe Fury janë të pamposhtur në karrierën e tyre dhe mbajnë titujt kampionë bote në peshën e rëndë. Duket se koha po kalon dhe ka gjasa të dështojë organizimi i sfidës në fund të prillit. Ndaj dhe Usyk i kërkon Fury të nxitojë: "Nëse ke frikë, tërhiq dhe mos mbaj peng sfidën. Jam gati të dueloj me ty kudo që dëshiron".

#### Edhe Gerrardi në listën e PSG-së

Një lajm surprizë qarkullon për të ardhmen e bankinës së Paris Saint-Germainit. Sipas "The Sun" dhe "The Scottish Daily Express", në listën e strategëve të mundshëm që mund të pasojnë Christophe Galtier është edhe Steven Gerrardi, një emër shumë i njohur për përvojën e jashtëzakonshme si futbollist te Liverpooli. Si trajner është shkarkuar në muajin tetor nga drejtimi i ekipit të Aston Villës. Për momentin është pa klube dhe mund të jetë një zgjedhje e mirë. Sipas medieve britanike, ai "shihet si figurë e rëndësishme, që mund të ndihmojë klubin të përmirësohet".

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Financave, Punëve dhe Transferëve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers  
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo

**NJOFTIM I SHITJES ME OFERTA TË MBYLLURA**  
**OBAVEŠTENJE O PRODAJI SA ZATVORENIM-PONUĐAMA** 21.02.2023

Sipas Ligjit Nr. 03/L-222 Neni 34, pasuria e përshkruar më poshtë është konfiskuar për mos pagesë të tatimit, nga Mbledhja e Detyruar e Tatimit. Pasuria do të shitet me ankand të ofertave të mbyllura sikurse është rregulluar në "Ligjin 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat" dhe Udhëzimin administrativ nr. 15/2010, neni 37.

Prema Zakonu br. 03 / L-222 Član 34, imovina opisana u nastavku oduzeta je zbog neplaćanja poreza, prinudnom naplatom poreza. Imovina će se prodati na aukciji zatvorenih ponuda kako je regulisano u „Zakonu 03 / L-222 o Poreska uprava i postupci“ i Administrativno uputstvo br. 15/2010, član 37.

Ofertat do të hapen për herën parë (1) 03.03.2023 (Enjte) ora 11:00 Vendi i shitjes Departamenti për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve. Veternik prapa Albi Mallë ngjitur me Doganë „Rr.Hasan Hasani Nr 40- Prishtinë.

Ponude će se otvoriti po prvi put (1): 03.03.2023 (Cetfertak) u 11:00 Mesto prodaje: Odeljenje za upravljanje naplatom dugova. Veternik iza Albi Mall-a pored Carine, ul. Hasan Hasani br. 40- Priština.

Përshkrimi i Pasurisë /Opis imovine:

1. Tokë (Kullosë e klasës IV – momentalisht ndodhen disa lloje të pemeve) ,Prona ndodhet ne fshatin PLAVË II Komuna e Dragashit ne numër te Parceles P – 70604032-00521-0 me sipërfaqe 7982
2. OFERTAT DO TË HAPEN : 03.03.2023
3. VENDI I SHITJES : ZYRAT E DMB – VETERNIK – PRISHTINË

1. Zemlja ( Pasnjak, klasa IV- momentalno na parceli se nalazi vocnjak), Zemljiste se nalazi u zvanom mestu Plava II Opština Dragas na broj parcele P – 70604032-00521-0 površine 798
2. Ponuda ce biti otvorena : 03.03.2023
3. Prodajno mesto : u Kancelariju OND – Veternikë - Prishtinë

Kushtet e pjesëmarrjes: kushti i pjesëmarrjes në ankand, kur kemi shitje të pasurisë së paluajtshme është paradhënia (garancia bankare) në shumën 10% të detyrimeve tatimore të pa paguara të tatimpaguesit. Paraqitja e Ofertave: Të gjitha ofertat qartë duhet të identifikojnë pasurinë e ofruar, shumën e ofertës, emrin, adresën dhe numrin e llogaris bankare të individit apo entitetit që paraqet ofertën, Ofertat duhet të pranohen në pliko (zarf) të mbyllur përpara datës dhe kohës të specifikuar më lartë.

/Uslovi učešća: Uslovi učešća u licitaciji, kada se radi e nepokretnoj imovini, je avans (bankarska garancija) u iznosu od 10% neisplaćenih poreskih obaveza poreskog obveznika. Dostavljanje ponuda: Sve ponude jasno identifikuju ponudjenu imovinu, iznos ponude, ime, adresu, i broj bankarskog računa pojedinca ili entiteta koji dostavlja ponudu treba da se primaju u zatvoreni pliko (koverat) pre gore specificiranog datuma i vremena . Pasuria mund të inspektohet në çdo dite pune prej orës 9:00 deri 15:00 nga data, 22.02.2023 deri më datën 02.03.2023 dhe mund të kontaktoni personat zyrtar në tel mobil: 044-394-444; 044-982-704; 044-354-276.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Kometa Transport” SH.P.K. me pronar Manuele Camozzato ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810806630 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da društvo sa “Kometa Transport” D.O.O. Manuele Camozzato donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810806630 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability “Kometa Transport” L.L.C. Manuele Camozzato has come to the decision to quit its business: 810806630 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook [www.facebook.com/gjeipuneshpejte](https://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

**RESTAURANT**

**SWISS**

**TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

**PRISHTINË**

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- “Albitaly Web” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. Unik Identifikues 810099508.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Dijar Hoti nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh Ekonomike “Kadri Kusari”.
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Adelina Salihu nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10.11 të SH.M. Ekonomike “ Kadri Kusari” Gjakovë.
- Drin Jakurti nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Shkelqim Rexha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shfmu “Yll Morina” Gjakovë nga kl.I-IX.
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Qëndrim Haziri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Shkelqim Rexha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shfmu “Mustafa Bakija” nga kl. I-V Gjakovë.
- Shqipe Mazreku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën diplomën e shm Mjekësisë “Hysni Zajmi”.



# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

## Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

